

## Orari mësimor në arsimin fillor:

Orët	Fillimi	Mbarimi
Ora e parë	08:20	09:05
Ora e dytë	09:10	09:55
Pushimi	09:55	10:25
Ora e tretë	10:25	11:10
Ora e katërt	11:15	12:00
Ora e pestë	12:05	12:50
Dreka	12:55	13:40
Studimi	14:00	14:55

## Gjuhët e huaja

Në Shkollën NEHEMIA zhvillohen këto gjuhë të huaja:

Gjuha angleze, si gjuhë e huaj e parë, ku synojmë mbrojtjen e nivelit B2, mësohet që në klasën e parë.

Gjuha gjermane, si gjuhë e huaj e dytë, ku synojmë mbrojtjen e nivelit B1, mësohet që në klasën e tretë.

## Aktivitete

Bazuar në planin vjetor, shkolla do të organizojë:

- Aktivitete në rang departamentesh
- Aktivitete sociale e kulturore
- Aktivitete sportive
- Konkurse e olimpiada
- Klube lëndore për zhvillimin e talenteve dhe përforcimin e njohurive
- Java e projekteve (24-28 maj)

## Shpërndarja e dëftesave:

- Klasat I-V: më 8 korrik 2022

## Biblioteka

Hapur: E hënë – të premte;  
Ora: 08:00 – 17:00



## Shkolla NEHEMIA

Nehemiah Gateway Albania  
Rr. Nehemia  
7304, Buçimas, Pogradec

Elona Rira  
Drejtoreshë e Shkollës NEHEMIA

T: +355 83 600403  
F: +355 83 600405  
C: +355 69 70 58 359  
E: elona.rira@ng.team



Arsimi Fillor  
(klasat I – V)

## Synimi i Shkollës NEHEMIA

Ne do të ofrojmë një arsim cilësor për nxënësit duke i aftësuar ata të fitojnë kompetenca dhe të formojnë personalitetin përmes zbulimit të botës, si dhe potencialeve të tyre.

Ne do të ofrojmë mundësi për ta që të provojnë situata të ndryshme të të nxënësve dhe të vetë jetës, duke inkurajuar lirinë dhe barazinë midis njerëzve, me qëllim që ata të marrin përgjegjësi për jetën, familjet e tyre dhe shoqërinë, në të cilën ata jetojnë.

## Objektivat e shkollës

### **Prioriteti 1. Përmirësimi i arritjeve dhe cilësisë së të nxënësve**

- Të rritet në masën 10% në çdo klasë numri i nxënësve që arrijnë në nivele më të larta duke plotësuar standardet e shkollës.
- Të përdoren metoda, teknologji digjitale në 50% të orës mësimore (100% të orëve) për të gjitha lëndët dhe nivelet arsimore.
- Të rritet me 10-20% numri i nxënësve pjesëmarrës në olimpiada/kurse lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe numri i nxënësve që mbrojnë gjuhët e huaja, anglisht dhe gjermanisht.

### **Prioriteti 2. Zhvillimi i projekteve kurrikulare e jashtëkurrikulare, aktiviteteve, klubeve/kurseve të pasdites dhe të nxënësve praktik, sipas interesave dhe prirjeve/talenteve të nxënësve.**

- Të aktivizohen në masën 100% nxënësi në projektet lëndore, ndërlëndore, jashtëkurrikulare, aktivitete kulturore, aktivitete me natyrë sociale etj.
- Të zhvillohen në mënyrë të rregullt dhe sipas një plani e kalendari klubet e pasdites, kurset për zhvillimin e talenteve (piano, violinë, pikturë, kërcim, sporte etj.) në bazë të fushatës "Talent Development".
- Të zhvillohen të paktën tri projekte sociale nga Qeveria e Nxënësve të shkollës në bashkëpunim me SMI-në.

## Te ne do të gjeni:

- Klimë mbështetëse dhe inkurajuese për të gjithë.
- Proces mësimor aktiv në përshtatje me nivelin e nxënësve.
- Kabinete funksionale në shërbim të nxënësve.
- Shanse të barabarta për prirjet e nxënësve të talentuar në fusha të ndryshme.
- Implementimin e vlerave të qëndrueshme të NG-së.
- Përkujdesje ndaj nxënësve që në momentin e ardhjes, qëndrimit në shkollë deri në momentin e largimit në shtëpi.
- Mensë moderne me një personel të kualifikuar që ofron gatime me vlera ushqyese e të shijshme.
- Ndihmë profesionale nga psikologu i shkollës në shërbim të nevojave psiko-sociale të nxënësve.
- Kombinim shumë të mirë të mësimin në prezencë me atë online dhe ndjekja e mësimin në kohë reale nga shtëpia në varësi të situatës shëndetësore të fëmijës, apo asaj të pandemisë.
- Informim i menjëhershëm mbi shëndetin, sjelljen dhe arritjet e nxënësve.
- Aplikim të sistemit të krediteve me qëllim rritjen e cilësisë së të nxënësve dhe uljen e tarifës së mësimdhënies për vitin pasardhës.



## Struktura e vitit shkollor 2021-2022

Shkolla NEHEMIA ndjek strukturën zyrtare sipas urdhrave dhe udhëzimeve të MASR-së. Për datat e pushimeve dhe ditët e festave kombëtare, shkolla respekton kalendarin e pushimeve zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

**Mësimi:** Viti shkollor fillon më 9 shtator 2021 dhe mbaron më 8 qershor 2022.

**Pushimet:** Fillojnë më 24 dhjetor 2021 dhe mbarojnë më 4 janar 2022.

## Bashkëpunimi mësues-nxënës-prindër

Takimet me prindërit do të zhvillohen sipas këtij kalendari:

Takimi	Data
1	24 shtator 2021
2	12 nëntor 2021
3	14 janar 2022
4	12 prill 2022
5	30 qershor 2022

